LIGJ
Nr.7586, datë 14.7.1992

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7547, DATË 6.1.1992 "PËR AKCIZAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Në mbështetje të neneve 13 dhe 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7547, datë 6.1.1992, në nenin 2, pas fjalës "fizikë" shtohen fjalët "vendas dhe të huaj".

Neni 2

Në nenin 3 bëhen këto ndryshime:
- Shkronja "a" ndryshohet si vijon:

a) Duhan e prodhime duhani	Përqindja e akcizës
- Cigare	60
- Puro	60
- Duhan	60
- Letër cigare	50

Në shkronjën "b", në paragrafin e katërt përqindja e akcizës ndryshohet si vijon :

	Përqindja e akcizës
- Konjak, uzo, fërnet, ponç, uiski, rum dhe të gjitha pijet e tjera alkoolike	70

- Shkronja "c" bëhet "f"

- Shtohen shkronjat "c", "ç", "d", dhe "dh" me këto përmbajtje:

c) Pije të buta dhe freskuese	20
ç) Ujë mineral (gline) dhe i gazuar.....	20
d) Energji elektrike.....	50
dh) Alkool për shitje.....	50

- Në fund të këtij neni shtohen dy paragrafe përkatësisht me këtë permbajtje:

"Për nënproduktet e naftës dhe për energjinë elektrike merret në formë akcize dhe diferenca ndërmjet çmimit shtetëror të miratuar të shitjes dhe çmimit të caktuar nga personat juridikë e fizikë, të cilit i shtohet 50 % akcizë".

"Për mallrat e përcaktuara në shkronjën "a", kur importohen,zbatohet një akcizë 30 % më e lartë dhe për ato të shkronjave "b"dhe "dh" 15 % më e lartë".

Neni 3

Neni 4 ndryshohet si vijon:

"Për mallrat që prodhohen brenda vendit, akcizat llogariten në bazë të vlerës së çdo sasie malli të shitur dhe detyrimi për pagimin e tyre fillon nga koha kur shitësi nis faturën në drejtim të blerësit.

Shitësi e shton akcizën në vlerën e faturës dhe mbledh akcizën nga blerësi për llogari të buxhetit të shtetit".

Neni 4

Në nenin 5, fjalët "në bazë të vlerës së doganuar" zëvendësohen me fjalët "në bazë të vleres doganore".

Neni 5

Neni 6 ndryshohet si vijon:

"Organet doganore detyrohen të bëjnë llogaritjen dhe arkëtimin e akcizës për mallrat që importohen dhe shuma derdhet çdo 5 ditë në buxhetin e shtetit për llogari të organeve tatimore".

Neni 6

Neni 9 ndryshohet si vijon:

"Akcizat derdhen në buxhetin e shtetit. Prodhuesit detyrohent'i llogaritin e t'i derdhin në buxhet akcizat çdo 5 ditë".

Neni 7

Neni 11 ndryshohet si vijon:

"Prodhuesit e importuesit e mallrave që tatohen me akcizat dhe organet doganore detyrohen të mbajnë llogari të veçantë, të plotësojnë dhe të dërgojnë në organet tatimore deklaratën periodike mujore për akcizat e realizuara e të derdhura, si dhe çdo informacion tjetër të kërkuar nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë.

Neni 8

Në nenin 14, në paragrafin e parë, para fjalës "rreth" shtohen fjalët "komunë, bashki e ...".

Në paragrafin e dytë, fjalët "te përgjegjësi i seksionit tëfinancës në rreth zëvendësohen me fjalët "te kryetari i zyrës sëtatimeve e taksave në komunë e bashki, te kryetari i degës së tatimeve e taksave në rreth".

Neni 9

Nenet 10 e 15 shfuqizohen.

Neni 10

Në nenet 14 e 16, pas fjalës "Financave" shtohen fjalët "dhe e Ekonomisë".

Neni 11

Ky ligj hyn në fuqi 5 ditë pas shpalljes së tij.

Shpallur me dekretin nr.262, datë 20.7.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.